

## Bashkëpunimi rajonal në Evropën Juglindore – Periudha pas Paktit të stabilitetit



## Hyrje

Ky hulumtim orvatet të japë një pasqyrë mbi ndryshimet strukturale dhe politike të tranzicionit nga Pakti i stabilitetit për Evropën juglindore në Këshillin për bashkëpunim rajonal (KBR). Përderisa Pakti i stabilitetit ishte në shumë aspekte i drejtuar nga komuniteti ndërkombëtar, qëllimi i KBR është të krijojë një "pronësi rajonale" gjithëpërfshirëse të iniciativave dhe misioneve ushtarake të themeluara në kuadër të KBR. Duke dhënë një pasqyrë të gjerë mbi punën e KBR, fokusi i këtij hulumtimi është mbi të arriturat e vitit të parë të bashkëpunimit rajonal me theks të veçantë në bashkëpunimin lidhur me sigurinë, si një nga prioritetet e KBR.

### 1. Shikim mbrapa: Pakti i stabilitetit për Evropën juglindore – Bashkëpunimi rajonal nën udhëheqje ndërkombëtare

Pakti i stabilitetit, i inicuar në vitin 1999 në Keln të Gjermanisë, synonte të përforcojë përpjekjet e vendeve në rajon në konsolidimin e paqes, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe rritjen e konomike. Ky pakt paraqiste strategjinë e parë gjithëpërfshirëse të komunitetit ndërkombëtar për parandalim të konflikteve, duke ofruar kornizë për bashkëpunim rajonal dhe marrëdhënie më të afërta me strukturat evropiane dhe evro-atlantike.

Paktit të stabilitetit për Evropën juglindore i paraprinë një sërë iniciativash për bashkëpunimin rajonal. Ndër to ishin Iniciativa e Evropës qendrore (CEI); Konferenca për fqinjësi të mirë; Procesi Royaumont (RP, 1995); Iniciativa e Evropës juglindore për bashkëpunim (SECI, 1995); Qasja rajonale e UE-së (RA-EU, 1996); Stabiliteti, Siguria dhe Bashkëpunimi në Ejl (CSEE, 1996) dhe Procesi i bashkëpunimit në Ejl (SEECp, 1996). Marrë parasysh që rajoni kaloi nëpër pesë konflikte ushtarake, iniciativat e sipërpërmendura mund të kuptohen si të paefektshme. SECI dhe Qasja rajonale e UE-së gjithashtu u ballafaquan me vështirësi në vendet e ish Jugosllavisë duke refuzuar cdo iniciativë që shiheshte si ringjallje e lidhjeve të vjetra Jugosllave.

Të gjitha iniciativat paraprake filluan të funksionojnë së bashku me Paktin e stabilitetit dhe tashmë janë të involvuara në bashkëpunimin rajonal. Procesi i bashkëpunimit në Ejl u themelua në vitin 1996 për të përforcuar bashkëpunimin nën-rajonal në fushën e sigurisë. Fokusi i tij shtriheshte në bashkëpunimin ndër-kufitar dhe bashkëpunim në drejtësi dhe marrëdhënie të brendshme, si dhe në luftimin e terrorizmit, krimin të organizuar dhe trafikimit të paligjshëm të drogave dhe armëve. SEECp luan një rol të rëndësishëm në punën e KBR, i cili do të elaborohet më poshtë.

Lufta në Kosovë dhe intervenimi i NATO-s erdhi si katalizator për koordinim dhe preventivë në rajon nën udhëheqje ndërkombëtare. Vetëm më pak se një javë pas fillimit të bombardimit në Kosovë, ministri i jashtëm i Gjermanisë Joska Fisher, solli idenë e Paktit të stabilitetit për Evropën juglindore. Disa muaj më vonë, më 10 Qershor 2009, me iniciativë të UE, dokumenti themelues detyroi më shumë se 40 shtete dhe organizata- ndër të cilat edhe shtetet anëtare të UE-së dhe Komisioni i UE-së, SHBA, KB, OBSE, Këshilli i Evropës, NATO, Banka Botërore, Banka Evropiane e investimeve, Iniciativa për bashkëpunim në Ejl, dhe kuptohet vendet e rajonit – për të ndihmuar vendet e Ejl në përforcimin e paqes dhe demokracisë. Në një anë, qëllimi i Paktit ishte të trajektojë përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar në rajon ndërsa në anën tjetër synonte të ofrojë një platformë për bashkëpunim ndërmjet vendeve të rajonit. Për të arritur këtë, duheshte t'i shërbejë qëllimit parësor të Paktit të stabilitetit, i cili konsistonte në ankimin vendeve të Ejl vendosshëm në vlerat dhe strukturat institucionale të Komunitetit Euro-atlantik.

Pakti i stabilitetit bazoheshte në eksperiencat dhe leksionet e marra nga menaxhimi i krizave ndërkombëtare në mbarë botën, e ndërtuar kryesisht nga sektorët si: krijimi i ambientit të sigurtë, promovimi i sistemeve demokratike të qëndrueshme, si dhe promovimi i mirëqenies sociale. Pakti mbështeteshte nga një Koordinator special, Erhard Busek dhe zyra e tij është në Bruksel. Karakteristikë e vecantë ishin takimet e punës në të cilat përfaqësues të vendeve të EJL ishin të njëtrajtshëm me organizatat ndërkombëtare dhe institucionet financiare në këshillimin lidhur me të ardhmen e rajonit dhe vendosjes së prioriteteve.

Sic u cek më lartë, dokumenti themelues gjithashtu premtoi integrimin euro-atlantik e të gjithë rajonit, përfshirë antarësimin e plotë eventual në UE. Në këtë kontekst, UE krijoi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) me shtetet e rajonit të cilat deri më tani nuk kishin marrëdhënie kontraktuale me Brukselin. Maqedonia ishte njëra nga vendet e tilla. Marrëveshjet e stabilizim asociimit janë dokumentet më të rëndësishme të Procesit të stabilizim asociimit, që ende paraqet kornizën kryesore të marrëdhënieve UE-Balkan perëndimor. Përpjekjet e Paktit kanë qenë komplementare ndaj atyre të Procesit të stabilizim asociimit. Në webfaqen e tij, Pakti theksonte se perspektiva evropiane është motivator kryesor për vendet në fjalë në kycjen e tyre në bashkëpunim rajonal dhe reforma ka qenë mjet crucial për suksesin e këtij pakti. Një zyrtar maqedonas u shpreh lidhur me këtë se “pakti i stabilitetit nuk do të kishte kurfare vlerash nëse nuk do të ngërthente në të perspektivën e antarësimin”.

Në fillim, Pakti ishte pak a shumë si platformë për koordinim të aktiviteteve donatore dhe krijim te fondeve për rekonstruim. Nëpër vite, ai gjithashtu u shëndrrua në një forum që sillte në një vend aktorë rajonal dhe ndërkombëtar me qëllim të formësimit të strategjive të përbashkëta për ardhmërinë e rajonit. Vendet e rajonit vendosmërinë e tyre për të marrë pjesë në Pakt e bazonin në përkrahjen e gjerë internacionale që gëzonte ky Pakt.

## 2. Nga Pakti i stabilitetit deri te Këshilli për bashkëpunim rajonal

Këshilli për bashkëpunim rajonal (KBR) ishte i dizajnuar rreth prioriteteve të definuara nga etë rajoni dhe oficalisht u promovua në Sofje më 27 Shkurt 2008. Vendet e EJL, shtetet donatore dhe aktorë tjerë ndërkombëtarë, si Komisioni evropian shprehën zotimin dhe përkrahjen e tyre për skemën e re që do të vijonte gjurmëve të Paktit të stabilitetit për EJL.

Qëllimi më i rëndësishëm i Këshillit është përkrahja e bashkëpunimit rajonal në EJL bazuar në principin e pronësisë rajonale, që con drejt implementimit të projekteve rajonale me beneficione për secilin shtet të rajonit. Sekretari gjeneral i KBR, Hido Biscevic, ish diplomat kroat me përvojë profesionale në bashkëpunimet rajonale dhe bilaterale, thekson faktin se KBR formon iniciativën e parë rajonale multilaterale dhe shumëanëshe në historinë moderne të EJL.

Vendet e rajonit udhëheqin me organizatën përderisa organizatat e jashtme si KB, BB, dhe UE veprojnë si antarë të barabartë të skemës.

KBR gjithashtu ishte dizajnuar të shërbejë si përforcues i integriteteve euro-atlantike të vendeve të rajonit. Njëjtë si Pakti i stabilitetit, operon në pajtim me Procesin a Stabilizim Asociimit të UE-së. Kycja e shteteve të rajonit në NATO formon një çështje tjetër të rëndësishme.

Një e treta e shpenzimeve të KBR mbulohen nga UE-ja. Ndërsa pjesa tjetër nga vendet pjesëmarrëse të Procesit të bashkëpunimit në EJL dhe donatorë nga Pakti i stabilitetit.

## 2.1. Struktura e KBR

KBR përbëhet nga Sekretariati i KBR, Sekretari gjeneral i KBR, Bordi i KBR si dhe nga antarët e KBR. Sekretariati i KBR është i vendosur në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë dhe ka zyre edhe në Bruksel ku Hido Basevic është Sekretar gjeneral. Sekretariati ofron përkrahje teknike, organizative dhe analitike për Sekretarin gjeneral, takimet vjetore të KBR dhe Bordit të KBR. Bordi i KBR i përbëre nga antarët e KBR që kontribuojnë në buxhetin e të ashtuquajturës Troika e UE-së (Presidenca e UE-së, Komisioni evropian dhe Sekretariati i këshillit evropian), ofron udhëzime operationale dhe mbikqyr organizatën. Bordi kryen detyrën e pranimit të Raportit vjetor të Sekretarit gjeneral dhe zbaton Programin strategjik të punës. 45 shtete, organizata dhe institucionet finansiare janë antare të KBR. Këtu përfshihen shtetet pjesëmarrëse në SEECP, një grup shtetesh donatore shumica e të cilave janë shtete evropiane, Unioni Evropian, Këshilli i Evropës, NATO, OSBE, OECD, Banka botërore dhe disa institucione të Kombeve të bashkuara si UNDP, UNECE dhe UNHCR. Kërkesat për antarësi nga shtetet ose organizatat kërkojnë pëlqimin e antarëve ekzistues. Takimi vjetor i KBR është i lidhur me Samitin e SEECP dhe mbahet bashkërishtë me Sekretarin gjeneral dhe autoritetet e SEECP. Takimet vjetore garantojnë koordinimin strategjik dhe zhvillimin e procesit të bashkëpunimit rajonal. Vendimet e KBR bazohen në konsensus.

## 2.2. Prioritetet e KBR

Në përgjithësi, KBR ka definuar gjashtë fusha prioritare për punën e tij: Zhvillimi ekonomik dhe social, energjia dhe infrastruktura, drejtësia dhe marrëdhëniet e brendshme, bashkëpunimi i sigurisë, ndërtimi i kapitalit njerëzor dhe bashkëpunimi parlamentar. Me qëllim të përkrahjes së prioriteteve, KBR ka krijuar fushë ekspertësh që dizajnojnë dhe implementojnë KBR programe dhe projekte lidhur me fushat prioritare. Fusha e ekspertëve përgadit ideja projektesh për donatorët ndërkombëtarë dhe zhvillon propozim projekte me organizata partnere. KBR ekspertët implementojnë strategjinë për komunikim të Sekretariatit të KBR përmes ligjeratave dhe komunikatave për mediat dhe në tërë rajonin.

### 2.2.1. Zhvillimi ekonomik dhe social

KBR përkrah zhvillimin e ekonomive prosperuese të tregut, sistemeve dhe politikave adekuate sociale duke u shëndërruar në fundament të ruajtjes së paqes dhe stabilitetit në EJT. KBR gjithashtu luan rol aktiv në koordinimin, lehtësimin dhe ofrimin e përkrahjes politike ndaj iniciativave ekonomike që synojnë lehtësim të investimeve, zhvillim të ndërmarrësisë së vogël dhe të mesme si dhe liberalizim të tregut.

Ndryshe nga rajonet tjera të Evropës, Evropa juglindore u ballafaqua me një ulje drastike në tregun rajonal gjatë viteve të 90. Arsyet për këtë rënie ishin restriksionet e tregut që u shfaqën pas shpërbërjes së Jugosllavisë dhe konflikteve ushtarake në rajon. Sidoqoftë, tregu rajonal u ripërtëri kah fundi i viteve 1990 dhe si pasojë e mungesës së qasjes në tregjet preferenciale të UE-së, tregu intra-rajonat formon një përqindje të lartë në importin dhe eksportin e më shumë shteteve të EJT.

Si vazhdimësi e punës së Paktit të stabilitetit, KBR kontribuon në punën e CEFTA-s. Me këtë marrëveshje, shtetet e involvuara synojnë të promovojnë tregun rajonal përmes shfuqizimit ose uljes së tarifave dhe eliminimit të barrierave pa tarifa.

Iniciativa tjera të rëndësishme të KBRR në fushën e ekonomisë dhe zhvillimit social janë Kompakti investues për EJT, Procesi për punësim i Bukureshtit si dhe Rrjeti i EJT për shëndetësi.

### 2.2.2. Energjetika dhe infrastruktura

Energjia dhe infrastruktura perceptohen nga KBR si parakushte më kryesore për zhvillimin e tërësishëm ekonomik, social dhe mjedisor, si dhe për stabilitetin dhe prosperitetin në rajon. KBR promovon zhvillim të qëndrueshëm energjetik në rajon dhe monitoron zhvillimin e një Komuniteti energjetik. Mes iniciativave tjera, KBR përkrah Sekretariatit obzervues permanent të transportit në EJL në themelimin e Komunitetit të transportit dhe implementimin e Hapësires evropiane për transport hekurudhor. KBR gjithashtu përkrah Procesin e Danubit për bashkëpunim dhe Komisionin ndërkombëtar të lumit Sava me qëllim të promovimit të përdorimit më racional të potencialit të lumit. Marrë parasysh problemet e ndotjes mjedisore, KBR bashkëpunon me Qendrën rajonale për mjedis si dhe Sekretariatit rajonal për rekonstruim të programit mjedisor.

### 2.2.3. Drejtësia dhe marrëdhëniet e brendshme

Fushat prioritate të KBR lidhur me drejtësinë dhe marrëdhëniet e brendshme përfshijnë luftimin e krimit të organizuar, aktivitetet antikorruption, aktivitetet lidhur me migracionin dhe azilin si dhe mbikqyrjen e zhvillimeve në UE lidhur me këtë fushë.

KBR gjithashtu ofron ekspertizë teknike dhe mirëmban lidhjet me grupe interesi relevante ndërkombëtare dhe nga sektori civil. Në këtë kontekst, KBR morri përsipër funksionin e Paktit të stabilitetit në bordet relevante. Në fushën e drejtësisë dhe marrëdhënieve të brendshme, KBR bazohet në punën e Paktit të stabilitetit dhe përpjekjeve për të ndarë praktikat më të mira dhe leksionet e mësuara ndër shtetet e rajonit. Iniciativat kryesore rajonale përfshijnë Qendrën SECI për luftimin e krimit ndër-kufitar, Grupi këshillues i prokurorëve në EJL, Sekretariati i iniciativës rajonale për antikorruption, Iniciativa rajonale për migracion, refugjatë dhe azil, si dhe Asociacioni i EJL për krerët policorë.

### 2.2.4. Bashkëpunimi për sigurinë

KBR është i angazhuar luftimin e sfidave ekzistuese dhe të ardhshme në nivel lokal dhe rajonal në fushën e sigurisë duke synuar të themelojë mjedis stabil të sigurisë në EJL. Bashkëpunimi rajonal i cili sipas KBR, duhet të përfundojë në një pronësi të tërësishme rajonale, do të ndihmojë në rritjen e efektivitetit në fushën e sigurisë. Në kuadër të KBR funksionojnë këta iniciativa: RACVIAC, SEESAC dhe DPPI. Sipas KBR, ata janë efikas dhe qëllimi parësor i tyre duhet të jetë pronësia e tërësishme rajonale. Lidhur me bashkëpunimin e sigurisë, KBR mbështetet në Paktin e stabilitetit dhe plotëson punën e SEECP. Përforcimi i koordinimit ndërmjet KBR dhe NATO si dhe KBR dhe UE do të shtyjë proceset e bashkëpunimit rajonal për sigurinë tutje. Gjithashtu, KBR i jep rëndësi edhe të ashtuquajturës Reforma në sektorin e sigurisë, përbërë nga përforcimi i kontrollit të organeve ligjvënëse në lidhje me forcat e armatosura dhe shërbimet e sigurisë. Për sa i përket KBR, Këshilli për bashkëpunim rajonal synon të rrisë transparencën e divizioneve funksionale në raport me komunitetin e donatorëve si dhe në promovimin e pronësisë lokale dhe ndërtimin e kapaciteteve koordinuese të qeverisë. Marrë parasysh faktin se koordinimi në mes aktorëve të qeverive ndërkombëtare dhe kombëtare në fushën e sigurisë ende është i pamjaftueshëm, ambicjet e KBR janë që të fitojë një rol kryesues në zhvillimin e reformave në sektorin e sigurisë.

### 2.2.5. Zhvillimi i kapitalit njerëzor

KBR dëshiron të komunikojë nocionin e quajtur Shoqëritë e bazuara në besim dhe promovon një kulturë tolerance dhe dialogu në EJL. Me qëllim të luftimit të stereotipeve që njerëzit mund të

kenë ndaj atyre të një vendi tjetër, rajoni, gjuhe ose kulture, KBR mbështet iniciativa pajtimi, shkëmbim kulturash dhe kontakte ndërmjet njerëzve.

Vëmendje e vecantë i kushtohet gjeneratës së re. Theks i vecantë vendoset në rëndësinë e edukimit dhe trajnimit psh. Përmes mbështetjes së bashkëpunimit të rajonit me programin për mësim të përjetshëm të UE-së. KBR gjithashtu fokusohet në politikat efektive për punësim me qëllim të krijimit të një stabiliteti të qëndrueshëm.

### 2.2.6. Bashkëpunimi parlamentar

KBR është aktivisht i involvuar në procesin e bashkëpunimit parlamentar, duke mbështetur Sekretariatit rajonal për bashkëpunim parlamentar në EJL. Ky sekretariat u themelua në Sofje të Bullgarisë. Qëllimi i tij është të intensifikojë bashkëpunimin parlamentar rajonal, duke siguruar koordinim dhe përkrahje politike për formulimin dhe implementimin e aktiviteteve rajonale. Sekretariati gjithashtu vepron si rrjet informativ ndërmjet parlamenteve të shteteve të rajonit. Bashkëpunimi më i fortë dhe i institucionalizuar ka për qëllim të forcojë demokracinë në parlament si dhe të promovojë bashkëpunim bilateral dhe multilateral ndërmjet parlamenteve.

### 2.3. Bashkëpunimi me aktorë tjerë

Përpjekjet e KBR kryesisht kanë të bëjnë me funksionimin e tij si pikë referuese për bashkëpunim rajonal, mirëmbajtjen e lidhjeve të punës me organizatat ndërkombëtare dhe qeveritë si dhe me sektorin civil. Detyra kryesore është ti ofrojë Procesit të bashkëpunimit në EJL kapacitete operacionale. Për më shumë, KBR vepron si forum për angazhim të vazhdueshëm të donatorëve të jashtëm. Me rastin e prezentimit të prioriteteve të tij në takimin me përfaqësues të institucioneve evropiane dhe euroatlantike, Sekretari gjeneral i KBR Hido Biscevic theksoi se KBR është partner kryesor i UE-së dhe komunitetit ndërkombëtar kur është fjala për çështje të bashkëpunimit në EJL.

Në këtë takim, disa nga përfaqësuesit e KBR vecuan se përmirësimi i relacioneve të vendeve të EJL me institucionet e UE-se dhe atyre euro-atlantike ndikon pozitivisht në gadishmërinë e shteteve për bashkëpunim rajonal. Gjithashtu, në një samit të liderëve rajonal të mbajtur në Qershor të 2009 në Kishinev, krerër rajonal të shteteve e aprovuan Deklaratën e Kishinevit. Me këtë rast, Biscevic tha se Deklarata e Kishinevit ofron një platformë më së të nevojshme për përfundimin e stabilitetit dhe integritetit përmes zhvillimit të përshpejtuar. Ai gjithashtu potencoi nevojën e ruajtjes së çështjeve bilaterale jashtë kornizës së KBR dhe se ishte e nevojshme të fokusohet në definimin e prioriteteve zhvillimore që do të përkrahin ekonominë kombëtare si dhe do të shpejtojnë reformat lidhur me UE-në, përfshirë mes tjerash sigurinë e energjisë dhe infrastrukturën.

### 2.4. Çështjet aktuale: roli i KBR në kohë të krizës financiare dhe sfidat e ardhshme të sigurisë

Në prezentimin e qershorit të vitit 2009, Hido Biscevic theksoi rolin e rëndësishëm që KBR luan në kontekst të krizës globale ekonomike dhe financiare, e cila ka kapluar edhe rajonin e EJL. Ai këtë e potencoi edhe më parë në samitin e liderëve të rajonit në Kishinev kur ceku se "raportet e mira fqinjësore janë esenciale për ecjen e rajonit përpara në këtë krizë ekonomike dhe financiare. Në Kishinev, krerët e shteteve dhe qeverive të vendeve të EJL gjithashtu bënë apel që KBR të themelojë një panel me ekspertë të nivelit të lartë për të stimuluar debat mbi masat që duhen ndërmarrë si

përgjigje ndaj krizës ekonomike. Më 22 Maj 2009, KBR bashkë me ministrin bullgar të mbrojtjes organizoi një takim për të diskutuar mënyrat e përforsimit të bashkëpunimit rajonal në siguri dhe mbrojtje. Takimi synoi të konsolidojë besimin dhe për të propozuar iniciativa të reja dhe teknika të përmirësimit të kornizës për bashkëpunim rajonal në mbrojtje. Kriza finansiare përsëri u përshkruajt si sfidë e sigurisë. Pjesëmarrësit u pajtuan që situata finansiare nuk duhet të kërcënojë nivelin e arritur të besimit të ndërmjetëm dhe se në këtë aspekt duhet detyrimisht të merren masa të qëndrueshme.

Një ditë më parë, më 21 Maj 2009, KBR së bashku me Zyrën e KB për drogë dhe krime nënshkruan një memorandum për përmirësim të mëtutjeshëm të sigurisë dhe promovimit të sundimit të ligjit në EJL. Cështjet e adresuara lidhur me trafikimin e drogës dhe krimin të organizuar në rajon u vendosën si prioritet të përbashkëta. Në këtë kontekst, Memorandumi i nënshkruar do të krijojë bazë për asistencë teknike në përforsimin e kapaciteteve nacionale dhe ndërkombëtare, zhvillimin e politikave dhe implementimin e standardeve dhe principeve të UE-së dhe KB. Ndarja e diturisë dhe praktikave më të suksesshme ndërmjet shteteve gjithashtu do të hasë në lehtësime të shumta nga memorandum i nënshkruar. Me këtë memorandum u bë marrëveshje edhe lidhur me organizimin e trajnimeve, projekteve rajonale dhe nacionale, kampanjave vetëdijësuese me qëllim të adresimit të problemeve sic janë larja e parave dhe finansimi i terrorizmit.

## 2.5. Viti i parë kaloi: Sukseset dhe sfidat që pasojnë në sektorin e sigurisë

Gjatë vitit të parë të KBR, për sa i përket fushës së sigurisë, Sekretariati i KBR u fokusua në përforsimin e pronësisë rajonale për përpjekjet e bashkëpunimit si dhe në identifikimin e nevojave për thellim të bashkëpunimit në mbrojtjen rajonale.

KBR dhe UNDP nënshkruan një marrëveshje të re me cka u zgjeruan aktivitetet e SEESAC, që solli deri të transformimi i tij në një skemë të parandalimit të dhunës në bashkësi. Si UNDP ashtu edhe SEESAC kërkuan nga Sekretariati i KBR që të kthejë vëmendjen e Bordit të KBR kah transformimi i SEESAC në një iniciativë të gjithëanshme rajonale.

Në një takim koordinues me DPPI SEE dhe SEESAC, të dyja palët u dakorduan që të operojnë nën skemën e KBR. Sekretariati i KBR ofroi përkrahje të plotë dhe lehtësoi kontaktet me donatorët ndërkombëtarë. Në bashkëpunim me DPPI SEE, Sekretariati i KBR gjithashtu ofroi asistencë edhe për UNDP në përgaditjen e Programit për reduktim të rrezikut të katastrofave në EJL. KBR ofroi përkrahje politike dhe dha udhëzime lidhur me transformimin e qendrës RACVIAC me seli në Kroaci. Një nga sfidat më të mëdha ishte ajo së antarët themelore të RACVIAC morrën përgjegjësi të plotë lidhur me buxhetin e organizatës për vitin 2009.

Fusha e cështjeve të mbrojtjes formoi një tjetër fokus të rëndësishëm brenda vitit të parë të KBR. Së bashku me Ministrinë bullgare të mbrojtjes, në Maj të 2009, KBR organizoi një takim të Udhëheqësve të politikave të mbrojtjes dhe atyre të bashkëpunimit ndërkombëtar nën ministrinë e mbrojtjes të shteteve të EJL. Krahas ndarjes së pritjeve dhe formulimit të teknikave dhe mundësive për përmirësim të bashkëpunimit të gjerë rajonal në siguri, takimi pati si qëllim themelimin e një dialogu permanent të Udhëheqësve të politikave të mbrojtjes në EJL, me këtë institucionalizimin e një formati të tillë në kuadër të KBR.

KBR gjithashtu zhvilloi edhe më tej dialogun me palët kryesore të interesuara në mbrojtjen rajonale dhe bashkëpunimin e sigurisë, përfshirë SEDM, DCAF, NATO dhe OSBE. Qëllimi i KBR është të parandalojë dyfishimin e aktiviteteve të organizatave tjera që vecmë janë të pranuar dhe përkrahura.

Në vitin e tij të parë, Sekretariati i KBR gjithashtu mori pjesë në krijimin e lehtësisë për sigurim të rrezikut të katastrofave në Evropën qendrore dhe juglindore (SECE-CRIF), bashkë me BB dhe Strategjinë e KB për reduktim të katastrofave. Në formë të partnershipit publiko-privat, SECE-CRIF do të lehtësojë zhvillimin e një sigurimi të katastrofave në 13 shtete të EJL. Së bashku me DPPI SEE, përkrahur nga UN ISDR dhe BB, SECE CRIF hartoi një projekt lidhur me krijimin e Qendrës rajonale për luftim të zjarreve (SEEFREC).

## Përmbledhje

Puna e KBR formon një kontinuitet të suksesshëm të përpjekjeve të Paktit të stabilitetit për EJL. KBR mund të shihet si iniciativa më gjithëpërfshirëse rajonale për bashkëpunim në EJL. Edhe në kohë të një vështirësie ekonomike, vendet e rajonit kanë treguar gadishmëri dhe kompetencë për të vazhduar bashkëpunimin në çështje të rëndësishme sic janë zhvillimi social dhe ekonomik si dhe rruajtja e paqes dhe sigurisë në rajon.

Gjithashtu, ndërmjet vendeve të EJL është evidente që ekziston një gadishmëri dhe vullnet për ndërmarrje të masave të koordinuara kundër krizës ekonomike. KBR funksionon si forum për formësimin e politikave në këtë fushë.

KBR vazhdon t'i ofrojë SEECIP-së kapacitete operationale. Përmes iniciativave të shumta, ai përkrah përpjekjet për bashkëpunim rajonal që merren me problemet në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes si SEESAC, DPPI SEE, SECE-CRIF dhe Qendra RACVIAC. Për më shumë, ai mirëmban relacionet me organizatat ndërkombëtare si KB dhe UE, qeveritë në Evropë dhe organizata të sektorit civil në mbarë botën.



## Programi për politikë të jashtme dhe siguri

“Bashkëpunimi rajonal në Evropën Juglindore – Periudha pas Paktit të stabilitetit”

\* Autorë: Manuela Riedeland Marnix Eichelberg.

Andreja Bogdanovski, Hulumtues i programit

[abogdanovski@analyticamk.org](mailto:abogdanovski@analyticamk.org)

### Analytica

Web: [www.analyticamk.org](http://www.analyticamk.org)

Email: [info@analyticamk.org](mailto:info@analyticamk.org)

Dame Gruev No: 7-8/3

1000 Skopje, Macedonia

Phone: 00 389 (0)2 3121 948

Fax: 00 389 (0)2 3121 948